Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**21.07.2023**	**24.07.2023**	**2023/0505**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **20.07.2023**, OE: **"MELTEX SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0505**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: **"RRONI" SH.P.K.- Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me emblema per Njesine Speciale"** me nr. të prokurimit: "**214-23-6309-1-3-6**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e kuotimit të çmimit, lloji i kontratës:furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **9,930.00 €**. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë **NUK** është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L -042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L -237, Ligjin 05/L -068, dhe Ligjin 05/L -092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Neni 1 – Qellimi i ligjit;

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti;

Neni 7 – Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi

Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi

Neni 60 – Kriteret e dhenies

Neni 69 – Kapaciteti teknik dhe/ose profesional

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Te nderuar,

AK- Policia e Kosovës ka shpallur aktivitetin e prokurimit " Furnizimi me emblema per Njësinë Speciale me Nr. prok. 214-23-6309-1-3-6

Mostrat te cilat ka ofruar OE i rekomanduar per kontrate nuk i plotësojnë kriterin e dosjes se tenderit saktësisht tek specifikimet teknike te dosjes se tenderit, sepse mostrat janë kërkuar qe te jene konform specifikimeve teknike te detyrueshme, kurse OE i rekomanduar per kontrate nuk e përmbush kriterin e kërkuar per shume arsye, e te cilat do ti elaborojmë si ne vijim:

Pretendimi ankimor nr. 1

Sipas Specifikimeve Teknike te detyrueshme te paraqitura ne Dosjen e Tenderit nga ana e AK-POLICIA KOSOVËS eshte kerkuar :

LOGO NJSI

LOGO NJSI

Mostra Obligative,

Diametri 8 cm

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Emblema të jetë e thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

Ndersa, OE i rekomanduar per kontrate "RRONI"SHPK Mostren per LOGON NJSI E KA OFRUAR si me poshte:

Ky lloj i mostres qe ka prezentuar OE i rekomanduar eshte i cilesise jashtzakonisht te dobet te mundur qe ekziston ne tregun Kosovar, andaj kjo llogo e ofruar nga ana e OE se rekomanduar, pasi qe ky OE I rekomanduar nuk e ploteson kriterin e kerkuar, por eshte turp qe Njesia me Elitare e Kosoves te mban mbi supet e saja LLOGO jo cilesore, apo llogo me te dobeta qe mund ti kete nje Polici ne tere Globin, andaj kjo eshte e papranueshme sepse nuk ndelidhet aspak me kerkesen e FDT-se, konkretisht me specifikimet teknike dhe bie ndesh me dispozitat ligjore te LPP-se siq eshte kerkuar ne kriterin e FDT-se, konkretisht te Kapaciteti Teknik dhe/ose professional.

Pra, nga fotoja me larte eshte llogoja e ofruar nga kompania RRONI , kurse me poshte e gjeni MOSTREN e ofruar nga ana jone (OE,MELTEX SHPK).

Shih mostrat e prezentuar nga ana e kompanis tonë

Nga mostrat e prezantuara, po te behet nje krahasim, shume qarte do te verehet se cila moster eshte konform kerkesave te Dosjes dhe cila moster, nuke permbush kriterin e kerkuar. Nga kjo shihet se OE. MELTEX eshte konform kerkesave te dosjes, kurse OE I rekomanduar nuk eshte as per se afermi te kerkesa e kerkuar.

Pretendimi Ankimor numer 2.

Sipas Specifikimeve Teknike te detyrueshme te paraqitura ne Dosjen e Tenderit nga ana e AK-POLICIA E KOSOVËS eshte kerkuar :

Numri i Prokurimit 214-23-6309-1-3-6 Titulli: Furnizim me emblema per Njesine Speciale



Mostra Obligative

Diametri 8 cm

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Emblema të jetë e thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

MOSTRA E OFRUAR NGA OE I REKOMANDUAR RRONI

Ky lloj i mostres se prezentuar nga ana e OE te rekomanduar per kontrate perveq cilesise se dobet me te mundshme qe ekziston ne tregun kosovar ka edhe :Pjesa e shkrimit ne pjesen e larte shkronjat jane te ngjitura me rrethin e zi (shih pjesen larte djathtas tek shkronjat ONS)

Prerja e llogos nuk eshte profesionale analizoni rrethine e jashtem ku shihet pjesa e materialit ngjyr e teget , ku ne disa zona eshte me e gjere e ne disa zona me e ngusht.

Shih mostrat e prezentuar nga ana e kompania jonë

Po ti merrni ti analizoni si OSHP qe mendojme se keni ekspert te kesaj lemie dhe shume lehte do ta beni dallimin dhe do ta kuptoni rendesine e tyre, qe vertetohet shume lehte siq eshte kerkuar dhe siq eshte ofruar.

Pretendimi Ankimor numer 3

Sipas Specifikimeve Teknike te detyrueshme te paraqitura ne Dosjen e Tenderit nga ana e AK-POLICIA E KOSOVËS eshte kerkuar :

LOGO - IEDD

Dimension 8 cm
Prapavija e logos ngjyre e kaltër e mbyllet
Harta e Kosovës ngjyre hiri
Akrepi (skorpion) ka ngjyre te verdh me te zeze
Granata e dorës ka ngjyre të bardhe me te zeze
Shkronjat (mbi shkrimi) janë me ngjyre te bardhe
Perimetri (rrethi) I jashtëm është me ngjyre hiri
Rrethi duhet të jetë I qendisur
Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .
Ëmblema të jetë e thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.
Mostra Obligative.

Ndersa OE i rekomanduar per kontrate "RRONI"SHPK Mostren per LOGON IEDD E KA OFRUAR

Mostrat e prezentuara nga ana e OE te rekomanduar per kontrate perveq cilesis jashtezakonisht te dobet qe ekziston ne tregun Kosovar, edhe ana profesionale e punimit eshte shqetesuese, pra nuk kemi te bejme me nje kompani e cila i punon llogot e Policise së Kosovës me nje shkalle te larte te profesionalizmit dhe cilësisë,
Shih pjesen e shkronjave ku formati dallon si per nga cilesia ashtu edhe per nga madhesia per secilen shkronje veq e veq, dizajni i shkronjave perveq cilesise duhet te kete edhe nje pamje te bukur per pjestaret e Policis se Kosoves.
Tek nje emblem eshte e rendesishme te shihen IKONAT se qka perfaqesojne psh : Shih pjesen e Bombes ku verehet se a eshte nje bomb apo qfar figure eshte , qka e bene te veshtir te dallohet se cilesin njesi e perfaqeson. Gjithashtu pjesa e rrethit te jashtem eshte prerja JO-PROFESIONALE!

Shih mostrat e prezentuar nga ana e kompanis tonë

Pretendimi Ankimor Numer 4

Sipas Specifikimeve Teknike te detyrueshme te paraqitura ne Dosjen e Tenderit nga ana e AK-POLICIA E KOSOVËS eshte kerkuar :

LOGO K-9

Materiali i bezit i punuar me kompjuter i qëndisur me penj të hollë dhe me ngjyra të ndryshme

Fillimi i rrethit të emblemës me ngjyrë të kaltër e mbyllët

Shkronjat me të bardha

Hapsira jashtë hartës së Kosovës me ngjyrë të zezë

Harta eKosovës me ngjyrë të hirit e qeltë

Fotografia e qenit të punohet me ngjyr të zezë dhe kafe , gjuha e kuqe si në foto

dimensioni i emblemes 8 cm

Në emblemë të shkruhet KOSOVO POLICE -SPECIAL UNIT kurse poshtë K-9

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Ëmblema të jetë e thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

Mostra Obligative.

Ndersa OE i rekomanduar per kontrate "RRONI"SHPK Mostren per LOGON K-9 E KA OFRUAR

Mostra e OE te rekomandaur per kontrate perveq joprofesionalizmit dhe cilesis te cilen e cekem edhe tek logot e tjera, gjithashtu edhe tek kjo LOGO kemi te bejme me joidentifikim te kjarte te figures qe perfaqeson njesinë perkatese.

Tek LOGO K-9 qe ka prezentuar OE i rekomanduar per kontrate , pjesa e figures se qenit nuk mund te bejme ne identifikim nga distanca me e vogel qofte edhe 1 Meter, se a kemi te bejme me nje figure te Qenit i cili eshte nga nje race tejet e qmueshme per Policinë qe ndihmon ne shume misione edhe jashtevendit , apo nje Figur te Ujkut.

Shih mostrat e prezentuar nga ana e kompanis tonë

Pretendimi Ankimor Numer 6

Sipas Specifikimeve Teknike te detyrueshme te paraqitura ne Dosjen e Tenderit nga ana e AK-POLICIA E KOSOVËS eshte kerkuar :

LOGO E POLICISË SË KOSOVËS

Mostra Obligative,

Diametri 9 cm , 7 Këndë

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Ëmblema të jetë e thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

Ndersa OE i rekomanduar per kontrate "RRONI"SHPK Mostren per LOGON E POLICIS SE KOSOVËS E KA OFRUAR

Mostra e OE te rekomanduar per kontrate nuk mund ta quajm as moster sepse nuk perfaqeson llogon e policis se Kosoves, mostra qe ka prezentuar OE i rekomanduar per kontrate eshte tejet e cilesis se dobet edhe per nje praktikant apo nje fillestar te kesaj fushe , i cili me nje pervoj shume te vogel apo me qarte te themii me nje pervoje 3-4 ditore do ta punonte me mire LLOGON qe e mban POLICA E SHTETIT te KOSOVES, e qe kjo moster nuk I permbush as per se afermi kerkesat minimale te kerkuara si ne Specifikimet teknike te detyrueshme.

Shih pjesen e larte (POLICE) ku te gjitha shkronjat jane te ngjitura njera me tjetren,

Sqarim, pasi qe ne si OE jemi profesionist te kesaj fushe, dhe kemi punuar LLOGO nga me te ndryshmet qe deri me tani nuk kemi as verejtjen me te vogel nga kontraktoret tane dhe kete LLOGO do ta punojme me pasionin me te madh pasi qe eshte UNIFORME POLICIE, dhe me mire te themi eshte Uniforma me e besueshme e shtetit dhe vendosja e nje LLOGO te dobet siq e ka ofruar OE I rekoamduar me siguri do ta kishte shemtuar edhe uniformen e bukur qe e ka policia jone, andaj kjo LLOGO nuk I permbush as per se afermi specifikat minimale te kerkuara.

Siperfaqja HIRI eshte aq e mbyllur saqe nuk e perfaqeson logon e POLICISË SË KOSOVËS dhe gjithashtu si rezultat i kesaj ngjyre te mbyllur edhe pjesa e Vijave ku eshte e qendisur me te kalter nuk verehet (analizojeni pjese e vijave te kalter te cilat nuk verehen fare).

Shih mostrat e prezentuar nga ana e kompanis tonë

Po te analizohet mostra jone me mostren e OE te rekomanduar si nga profesionistet apo pjestaret e Policise me siguri do ta verejne dallimin e madh qe kane dy LLOGOT dhe te gjithe do ta kishin refuzuar MOSTREN E OFRUAR NGA ANA E OE se REKOMANDUAR.

Pretendimi Ankimor Numer 7

Sipas Specifikimeve Teknike te detyrueshme te paraqitura ne Dosjen e Tenderit nga ana e AK-POLICIA E KOSOVËS eshte kerkuar :

FLAMURI I KOSOVËS

Mostra Obligative,

Dimensionet: 6 cm me 4.5 cm

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Flamuri të jetë e thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

Ndersa OE i rekomanduar per kontrate "RRONI"SHPK Mostren per LOGON PER FLAMURIN E KOSOVËS E KA OFRUAR

Mosta e prezentuar nga ana e OE te rekomanduar nuk eshte ne perputhshmeri me specifikimet teknike te kerkuara te DOSJES SE TENDERIT, ngase ngjyra e rretheve dhe shkrimit KOSOVA nuk eshte ne perputhshmeri me kerkesen e AK dhe foton e flamurit te Kosoves siq eshte kerkuar ne Specifikime teknike andaj eshte shume e lehte per ta dalluar mostren e ofruar nga OE I rekomanduar dhe te kerkuar ne dosje nga ana e AK-se.

Shih mostrat e prezentuar nga ana e kompanis tonë

Pra duke u bazuar ne mostrat e ofruara nga ana e OE te rekomanduar per Kontrat dhe nese bejme krahasim me Mostrat e prezentuara nga ana e Kompanis tone ''MELTEX SHPK'' kemi nje dallim jashtëzakonisht te larte si per nga cilesia ashtu edhe nga pamja fizike, sinqerisht eshte TURP sepse Policia e Kosovës ne shumë raste prezentohet dhe logot e vendosura nga OE i rekomanduar jane TURP te shihen ne uniformat e POLICISË SË KOSOVËS nga koleget e shteteve tjera,ngase vendosja e ketyre mostrave qe ka ofruar OE I rekomanduar ne uniformat e policis se Kosoves definitivisht e shumton uniformen e policis së Kosovës!

Komisioni I vleresimit, e ka obligim ligjor gjate vleresimit te ofertave te vlersoj ne baze te kritereve te kerkuara ne njoftim per kontrate dhe dosje te tenderit sepse pergjegjesia per vlersimin e ofertes I takon si komisionit po ashtu edhe zyrtarit pergjegjes te prokurimit ,pasi qe zyrtari pergjegjes eshte kompetent per te verifikuar shkeljet ne rast se ndodh nga komisioni I vleresimit I cili ne kete rast shihet haptazi se komisioni I vleresimit ka bere shkelje te kritereve te kerkuara andaj zyrtari pergjegjes ka mund ta korigjoj leshimin e bere nga komisioni I vleresimit dhe procedura te ishte perfunduar konform kritereve te kerkuara.

Paragrafi 1 i nenit 59 te LPP-se thote: Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. **Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.**

-Pra, kete shkelje te komisionit te vleresimit, ka mund ta evitoj Zyrtari Pergjegjes I Prokurimit (ZPP).

Nga kjo nenkuptojme se OE I rekomanduar''RRONI ''SHPK nuk e ploteson kriterin e FDT-se dhe bazuar ne nenin 59.4 te LPP-se, ky OE eshte I papergjegjshem, sepse shume qarte e citon neni 59.4 I LPP-se e qe thote:
Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Te gjitha provat e deshmuara ne kete ankese e deshmojne se OE I rekomanduar per kontrate'' RRONI''SHPK eshte I papergjegjshem, dhe nuk ka qene dasht te shperblehet me kontrate ashtu siq ka vepruar Autoriteti Kontraktues –POLICIA E KOSOVËS.

Lidhur me oferten tone, pasi qe AK e ka konsideruar te papergjegjshme per mostat, ju sqarojme se ne si OE jemi i pergjegjshem poashtu i plotesojme te gjitha kriteret e FDT-se dhe Njoftimit per kontrate dhe ne si OE duhet te rekomandohemi per kontrate pasi qe jemi edhe me cmim me te lire se OE i rekomanduar(ku dallimi ne çmim eshte 2,389.00 €) andaj ju si OSHP duhet te merrni parasysh edhe kursimin e buxhetit publik, sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-se.

AK-Policia e Kosoves ka bere edhe shkeljen e nenit 7 te LPP-se, konkretisht nenit 69 te LPP-se, pasi qe ka rekomanduar per kontrate nje OE te papergjegjshem, ku sig shihet shume qarte nga

nuk I ploteson kriteret e FDT-se, konkretisht mostrat, poashtu ka cmimin me te larte se Oferta jone, dhe kjo bie ndesh me nenin 1, 6, 7, 59 dhe 69 te LPP-se.

Pra, te gjitha faktet e paraqitura ne kete Ankese jane te qendrueshme andaj kerkojme nga eksperti shqyrtues edhe paneli qe te bejne nje analize te mire te te gjitha mostrave te OE te rekomanduar dhe me krahasimin me te vogel lehtesishte vime ne perfundim qe OE I rekomonduar nuk e ploteson kriterin e FDT-se.

Kerkojme nga ana e juaj si Organ Shqyrtues I Prokurimit qe te merrni:

V E N D I M

I APROVOHET si e bazuar ankesa e **OE MELTEX SHPK**

II. OBLIGOHET AK –POLICIA E KOSOVËS **të Anuloj Njoftimin mbi vendimin e AK te dates 05.07.2023 dhe Lenda te kthehet ne RI-VLERSIM**

III. Gjate fazes se RIVLERESIMIT, AK ti trajtoni te gjitha ofertat njejte dhe te merrni parasysh edhe kursimin e buxhetit .

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues si dhe Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet –janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull para afatit të fundit të pranimit të ofertave ora 14 : 00.	**a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull para afatit të fundit të pranimit të ofertave ora 14 : 00.**

Aneksi 1. **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka

pretendime ankimore).

OE: **Meltex Shpk** – eliminohet pasi nuk i plotëson specifikat teknike pasi qe ne specifikat teknike është kërkuar.

Pas shikimit te mostrave dhe krahasimit me specifikikacionet e kërkuara i njëjti nuk i plotëson kushtet per shkak te mos përmbushjes se specikacioneve te kërkuara:

Te logo NJSI

Është kërkuar qe pjesa e brendshme te ketë ngjyre te gjelbër ushtarake, ndërsa ne mostrën e ofruar nga OE është ngjyre e gjelbër me shkëlqim,

Është kërkuar qe emblema te ketë pjesën tjetre mbrapa VELCRO per fiksim ne uniforme, ndërsa OE nuk e ka ofruar per secilën embleme nga një mostër por 3 emblema janë ngjitur ne një pjese VELCRO me katër kënde.

Te logo NJSO,

Është kërkuar qe emblema te ketë pjesën tjetre mbrapa VELCRO per fiksim ne uniforme, ndërsa OE nuk e ka ofruar pjese VELCRO te veçanta per secilën emblema nga një pjese, por 3 emblema janë ngjitur ne një pjese VELCRO me katër kënde.

Te logo IEDD,

Është kërkuar qe emblema te ketë pjesën tjetre mbrapa VELCRO per fiksim ne uniforme, ndërsa OE nuk e ka ofruar per secilën embleme nga një mostër por 3 emblema janë ngjitur ne një pjese.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **MELTEX SH.P.K.**

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, lidhur me arsyetimet e eliminimit ne letrën standarde per tenderues te eliminuar, ju sqarojmë se mostrat tona te prezantuara me rastin e ofertimit, janë te gjitha sipas specifikimeve te kërkuara, andaj arsyeja e te njëjtës është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dëshmitë, faktet e prezantuara nga OE ankues përmes fotografive me ngjyra vërehen qarte se janë disa dallimesh p.sh.:

TEK LOGO NJSI – ngjyra (*por AK ka prezantuar dy logo njëra me ngjyre te gjelbër ushtarake ndërsa, tjera me dy ngjyra qe janë me te hapura*), qe do te thotë se OE ankues ka dorëzuar mostrën ne pajtim me aneksin 1 te FDT-së;

TEK LOGO NJSO, ngjyrat nuk i posedon sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktues ne Aneksin 1 te FDT-së, pasi qe vërehen janë me te hapura, kurse shkronjat nuk janë te rregulluara sa duhet sipas kërkesës nga autoriteti kontraktues ne aneksin 1 te FDT-së;

TEK LOGO IEDD, pjesa e bombës nuk është e theksuar sa duhet pasi qe me vështirësi dallohet, qepja ne rrethin e jashtëm është jo e drejt;

TEK LOGO K9 – harta është më e madhe se sa kërkesa e autoriteti kontraktues, figura e dukjes se qenit është e jo e qartësuar, ashtu siç është kërkuar ne aneksin 1 te FDT-së;

TEK LOGO e PK-së, tek mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, dallon ngjyra si dhe pjesa e vijave te kaltër vërehen fare pak qe do te thotë nuk është sipas aneksit 1 te FDT-se;

TEK FLAMURI I KOSOVES - tek mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, dallojnë ngjyrat, thurja skajeve te flamurit dallojnë si dhe po ashtu dallon ngjyra që do thotë se dallon nga kërkesa e AK në aneksin 1 të FDT-së;

Duke marr për bazë se pretendimet ankimore kanë te bëjnë me mostrat e prezantuar nga OE, atëherë sipas **nenit 59 te LPP-se, si dhe nenit 37 te Rregullores nr. 001/2022 per Prokurimi Publik**, ku vlerësimi është ne diskrecion te AK-së – sepse ESH po te shikoj apo inspektoj mostrat atëherë ndërhyn ne përgjegjësin/kompetencat e AK, mirëpo ESH bazohet ne faktet dhe dëshmitë e prezantuar nga OE ankues (sqarim: *AK te inspektoj me kujdes mostrat dhe te*

respektoj nenin 59 të LPP-së, dhe nëse asnjë nga OE nuk arrin te kaloj inspektimin e mostrave ashtu siç janë kërkuar nga AK, atëherë te veproj sipas nenit 62 të LPP-së) prandaj ESH sqaron se AK – komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar sipas **nenit 59 par. 4 të LPP-së,** ku thotë: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".* Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë të qëndrueshëm.**

<u>Përgjigje në pretendimi nr. 2</u>

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, lidhur me ofertën tone , pasi AK e ka konsideruar te papërgjegjshme per mostrat, ju sqarojmë ese ne si OE jemi te përgjegjshëm po ashtu i plotësojmë te gjitha kriteret e FDT-se dhe njoftimit per kontrate.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne raportin e vlerësimit, letrën standarde te eliminimi, mostrave te fotografuar dhe vendimit mbi refuzimin e kërkesës per rishqyrtim, se arsyetimi i dhëne ne raportin e vlerësimit nuk qëndron pasi qe AK ne ankesin 1 te FDT-se ka kërkuar per secilën LOGO po citoj: ***"Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë***" te cilën pjesë OE ankues e ka plotësuar këtë kërkesë, por ka vendos disa emblema ne një pjesë VELCRO me katër kënde, që do thotë se AK nuk ka kërkuar qe secila ëmble te ketë te veçantë por secila embleme te jetë me VELCRO, sepse këto janë mostra dhe sigurisht OE ankues është i vetëdijshëm se secila emblemë duhet ta ketë pjesën VELCRO, por ketë e ka sjellë si mostër për AK, dhe për çdo dyshim AK ka mundur të veproj sipas **nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së**, dhe jo te eliminoj OE për diçka që nuk është specifikuar sakta duke lenë dykuptimësi, prandaj konsideroj se AK – komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 7 par. 2 të LPP-së**, ku thotë: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë të qëndrueshëm.**

<u>Përgjigje në pretendimi nr. 3</u>

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues,se AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues sqaron**, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të

dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e-prokurim ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me date 10.07.2023, kurse ZPP me date 11.07.2023 përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke vepruar ne pajtim te plotë me **nenin 108/A par. 9 të LPP-së**, ku thotë: *"Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë."* si dhe **nenin 108/A par. 12 të LPP-së, ku thotë:** *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë",* mirëpo bazuar ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës per rishqyrtim, nuk janë bindëse dhe as te argumentuar ne gjuhen e fakteve dhe argumenteve - provave apo te bazuar ne dispozita ligjore te LPP-se, por me shume i ngjanë një përshkrimi, duke mos arritur te argumentohet e kundërta e pretendimeve te OE ankues, me fakte dhe argument konkrete dhe bindëse, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur as nga komisioni i vlerësimit ne raportin e tij dhe as ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ZPP, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika **janë pjesërisht të qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60, të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe Aneksin 7 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë*) dhe rekomandon që të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimin për dhëni të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **MELTEX SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Sahit Beqiri